

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: "Rexhepi & Zeqiri" L.L.C. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 01.08.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "Rexhepi & Zeqiri" L.L.C. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **OFRIMI I SHËRBIMEVE JURIDIKE LIGJORE PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: 623-22-6452-2-2-1, Numër i brendshëm: 623-22-024-2-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: "Rexhepi & Zeqiri" L.L.C. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **OFRIMI I SHËRBIMEVE JURIDIKE LIGJORE PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: 623-22-6452-2-2-1, Numër i brendshëm: 623-22-024-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 27.07.2022, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **OFRIMI I SHËRBIMEVE JURIDIKE LIGJORE PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: 623-22-6452-2-2-1, Numër i brendshëm: 623-22-024-2-2-1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "Rexhepi & Zeqiri" L.L.C. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **OFRIMI I SHËRBIMEVE JURIDIKE LIGJORE PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: 623-22-6452-2-2-1, Numër i brendshëm: 623-22-024-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 27.07.2022, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks.gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 27.07.2022, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Ne baze te pretendimit tuaj se gjatë hartimit të paramasës Autoriteti Kontraktues ka gabuar në aplikimin e formulave ne Excel, kur njëra nga pozicionet është peshuar gabimisht.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, tutje ju sqaron se: Tre (3) ofertuesit, nga gjithsej Katër (4) ofertat e pranuar nga AK, në ofertat e tyre kanë bashkangjitur çmimin (ofertën) me paramasën e cila nuk ka përfshirë pjesën tek 3. Mjetet juridike në qeshtjet civile, totale për të gjitha pozicione: 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; por tek **çmimi total i pozicionit 3**, ka përfshirë vetëm pozicionin 3.1, ku ne baze te kësaj, tre (3) ofertuesit kanë, Gabimet aritmetikore të evidentuar është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës, ku sipas A01 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, Neni 41.8 (ii) thotë: *Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se + 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42.*, ku këta tre (3) ofertues i ka njoftuar ne baze te formularit: B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar

Në rastin konkret mund të paraqes keqkuptim/keqinterpretime gjatë ekzekutimit të kontratës nga operatori fitues, andaj ky gabim i Autoritetit Kontraktues konform RrUOPP neni 44.5, konsideroj e detyron të njëjtin që të anulohet aktivitetin e prokurimit.

A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik:

44.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

(ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

Për këtë çështje ka vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. 795/21.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks.gov.net>